

VENDIM
Nr. 556, datë 27.6.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
NDËRTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË PORTIT TË JAHTVEVE NË PORTO-PALERMO, HIMARË,
DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I
JEPET SUBJEKTIT “STUDIO A.M.Z.”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pikat 1, e 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoritete kontraktuese për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të ndërtimit të portit të jahteve në Porto-Palermo, Himarë, janë Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Mbrojtjes.
2. Koncesioni do të jetë i formës “BOT” (ndërtim - shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit).
3. Miratimin e bonusit prej 8% të pikëve për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën për zgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet subjektit “Studio A.M.Z.”.
4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha